



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 10.5.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Salih Morina, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi.

Munguan : Etem Arifi, Rasim Demiri.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Kryeshefi i APK, Drejtori i dep. për Pyje në MB, zyrtarët për Pyje nga 12 komuna të Kosovës, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit dt. 3.5.2011.**
- 3. Shqyrtimi problemeve aktuale rreth pyjeve në Kosovë, bashkërisht me zyrtarët e APK dhe ministrisë së bujqësisë.**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 3.5.2011

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa ndonjë vërejtje, gjithashtu edhe raporti për takimin e komisionit në Dragash, e cila është plotësuar sipas kërkesave nga mbledhja e fundit.

3. Shqyrtimi problemeve aktuale rreth pyjeve në Kosovë, bashkërisht me zyrtarët e APK dhe ministrisë së bujqësisë

Nait Hasani përshëndeti dhe falënderoj pjesëmarrësit dhe mysafirët e ftuar të cilët janë përgjigjur në ftesën e komisionit për debatin e sotëm rreth problemeve me pyje në Kosovë. Ai sqaroi se komisioni ka ftuar përfaqësuesit e APK dhe ministrisë së bujqësisë si dhe përfaqësuesit e komunave të cilët kanë më tepër qasje në pyje për të hulumtuar sa më mirë problematikën ngase është duke u hartuar një ligj i ri lidhur me pyjet. Neve si komision, përgjegjësia na angazhon edhe në fushën e pyjeve të japim kontributin tonë rreth ligjit për pyjet dhe organizimin institucional, sa kush kontribuon dhe a munden më tepër me kontribuu : APK, Ministria, Zyrat regjionale dhe Zyrat Komunale. Sidomos duhet të analizohet niveli i bartjes së kompetencave nëpër komuna ngase sugjerimet që janë dal edhe pas ndryshimeve për së treti herë, na tregojnë se një ligj duhet të hartohet ashtu si duhet, e jo të ndryshohet shpesh. Për të marr një informatë të përgjithshme, ne kemi menduar që paraprakisht ju do të informoni këtë komision, për të pasur mundësi trajtimin e mëtejme në Kuvend.

Liburn Aliu falënderoj dhe luti mysafirët për informata detale, sepse në vjeshtë duhet të trajtohet ligji i ri. Tani për tani pyjet trajtohen nga tri nivele, ndaj presim nga komunat kryesore të informohemi si munden me u ndalua prerjet ilegale, si mundemi ne të reagojmë etj.

Daut Haradinaj përshëndeti duke potencuar Dukagjinin me probleme rreth pyjeve që meritojnë të trajtohen. Mendimet e të ftuarve tha se do të janë të mirëseardhura për komisionin, ngase në bazë të rekomandimeve nga ky takim do të rekomandoj edhe komisioni lidhur me ndaljen e keqtrajtimit të pyjeve tona sepse mund të thuhet lirisht se kemi të bëjmë me “masakër të pyjeve” në këtë rajon. Gjithashtu do të inicohet demarkacioni me Malin e Zi ngase atje epen leje për prerjen e pyjeve tona, një absurd.

Afërdita Berisha tha dëshirojmë një ligj për interesa të përgjithshme. Sipas SNV Holandeze brenga kryesore është prerja e paplanifikuar e pyjeve, ndërsa APK, sipas informatave që kamë, ka mungesë të stafit, subvencione pyjore nuk ka pasur që nga viti 1999 etj etj, duhet të qasemi shumë mirë për të pasur një ligj të mirë për ti ruajt pyjet.

Nijazi Idrizi ishte i mendimit se ligji i vitit 2003 për pyje nuk po arrin të zbatohet, ndaj u interesua ti dëgjoj fillimisht problemet nga komunat, dhe **Salih Morina** gjithashtu u deklarua të dëgjoj prononcimet nga mysafirët.

Hysen Abazi nga MB tha se Ligji i Pyjeve është një ndër ligjet e para të Kuvendit me mangësi por qysh atëherë u potencua në këtë komision “më mirë një ligj i keq sesa asnjë ligj”. Një herë është amenduar më 2004 lidhur me ndëshkimet, pastaj edhe një herë lidhur me kompetencat komunale më 2010. Kompetencat kanë kalua komunave në korrikun e vitit të kaluar (2010) mirëpo përkundër problemeve situata dukshëm është përmirësuar. Tani është duke u hartuar ligji i ri dhe mund të thuhet se i vetmi vakum ka mbetur struktura organizative për menaxhimin me pyje. Është dashur që vitin e kaluar të miratohet ligji por ka mbetur për sivjet ngase duhet të analizohen mirë të gjitha çështjet relevante, përndryshe ky ligj u hartua në bazë të planit dhe strategjisë 10 vjeçare i cili ligj gjithashtu ka sigurua donator lidhur me këto qëllime strategjike.

Ahmet Zejnullahu kryeshef i APK në fillim njoftoi me statistikën siç janë sipërfaqja e Kosovës sa i përket pyjeve (464.800 ha me pyje, prej tyre 220,600 ha publike, 185.000 ha private ose 40% private), llojet e drunjve (bungu, ahu, halore, harqi, bredhi, pisha etj). Vëllimi total 52 milion metër kub, me shtim vjetor 1 milion e 200.000 metër kub. Ka edhe sipërfaqe të zhveshur e cila duhet të mbjellët me fidanë, rreth 30.000 ha. Planet menaxhuese për pyjet publike që duhet të zbatohen janë hartuar që nga viti 2007 si dhe ato vjetore që janë me bashkëpunim të komunave të miratuara më 27 janar 2011 për mbrojtjen e pyjeve, janë vendosur pikat e kontrollit edhe për disa komuna që nuk kanë qenë përpara (Podujevë, Mitrovicë), por mund të them se nuk jemi të kënaqën ngase prerjet nuk ndalen. Janë parashtruar mbi 7000 fletëparaqitje (kundërvajtje dhe penale) por ngecjet e mëdha ndodhin

nëpër Gjykata. Çështja e recidivistëve aspak nuk është ndalur, të njëjtit prapë vazhdojnë të shkatërrojnë pyjet. Mbrotjtja e pyjeve nga zjarri është më e mirë se në vitet e mëparshme, janë angazhuar 50 puntorë sezonal, sidomos në Istog është vërejtur përmirësimi në këtë drejtim. Sa i përket ndërprerjes së prerjeve ilegale, duhet mirë të hartohen planet për prerjet legale për 130.000 metra kub në vjet. Gjendja e tanishme tregon se është alarmuese, por urgjentisht duhet të zbatohen planet për këto prerje me mbikëqyrje të duhur. Pyllëzimet do të ndihmohen nga Instituti i Pejës ku prodhohen fidane (2 milion copë fidane për vit) duke pyllëzuar 450 ha, poashtu edhe për sektorin privat parashihet të epen fidanet. Niveli komunal i lejeve për prerje ka probleme sidomos për shkak të mungesës së stafit, automjeteve etj . Policia nuk insiston të hulumtoi prejardhjen e masës drusore pasi që vjedhësit ikun posa e shohin policinë, e lënë traktorin i cili zakonisht është pa targë, pra kemi moszbatimin e ligjit dhe lejohet të sillen si të dojnë. Kjo tregon se planet duhet të zbatohen ashtu si jemi marr vesh me angazhim shtesë. Nëse nuk publikohen këto fakte, nuk mund të presim rezultate, përfundoi. Përfaqësuesi i komunës së **Prishtinës** u pajtua se kemi ca rezultate fillestare, por dëmtimet e pyjeve ende vazhdojnë, ndaj sfidat aktuale sipas tij janë procesimi i administrimit të cilat nuk janë funksionalizuar me bashkëpunimin Komunë-Polici-Gjykatë, me një fjalë lëndët në Gjykata flejnë. Problem aktual është se dëmtuesit serik të prerësve ilegal nuk janë eliminuar, bashkë me transportin ilegal ngase kompetencat janë të paqarta. Mjetet financiare duhet të janë të qarta për pylltari sepse nuk ka mundësi për ritjen e stafit pra të kemi një staf përgjegjës, rojet nuk janë efikas, procedurat për largimin e tyre nga puna janë të komplikuar. Bashkëpunimi me nivelin qendror është por nuk ka specifikim të kompetencave (përzierje të kompetencave).

Përfaqësuesi i **Kamenicës** përshëndeti këtë hap të komisionit për një ligj të ri por edhe efikas. Komunitat janë më afër pyjeve dhe ato patjetër duhet të mbrohen. Kamenica ka pranuar kompetencat e dhëna komunale dhe ka pasur rast të shoh mundësitë që ofrohen me ato, megjithatë decentralizimi i ofruar i Ahtisarit nuk ofron qartësi. Nisemi nga dhënja e lejeve të cilat prekun direkt qytetarin, ngase procedurat janë të panevojshme dhe të stërzgatura për pronarët privat. Agjencia jepte leje, tani po jap edhe Komuna, dyfishohen procedurat e kështu me radhë. Agjencia i ka njerëzit e kualifikuar, ngase komunave ju ka lënë ata të pakualifikuar dmth ose APK ose Komuna duhet ti marr këto punë komplet (dëmkosje e vulosje). P.sh. komuna Ranillukut ka tri roje, ndërsa ne nuk kemi asnjë ndaj detyrohemi të kemi shpenzime lidhur me këto çështje, derisa buxheti që mbetet i kthehet buxhetit qendror. Ai me cifra tregoi se komunës nuk po i mbeten 30% sipas ligjit, por edhe ajo duhet të ngritet në 40% sepse ka shpenzime teknike për mbrojtjen e pyjeve. Nuk është faji i APK, vazhdoi, por te forma organizative, por në fund pësojnë pyjet. Ligji në fuqi është copy-paste e ndonjë ligji të shtetit të rajonit, tenderimi gjithashtu aspak nuk është në rregull ngase kompanitë kryejnë ato por qytetarët prapë mbesin pa dru, drunjt shkojnë në Prizren e gjetiu. Agjencia vet i bënë politikat, vet i kontrollon, kufizon etj, derisa pagat prej 180 euro mos të flasim, ka edhe shumë gjëra tjera.

Përfaqësuesi i **Gjilanit** tha se këto kompetenca kanë ardhur në një kohë të papërshtatshme ngase sfidat janë të trashëguar me një staf të pakualifikuar si të rojeve të pyllit ashtu edhe tjerëve, inxhinjerët e kualifikuar kanë mbetur në APK. Mjetet financiare nuk mjaftojnë ngase ato shkojnë në APK. Deri tani kemi bërë një lloj damping fushate por më nuk kemi fuqi, ngase fjala është për qytetarin. Kjo vendosmëri e jona dha fryte, vazhdoi, por prapë kemi të papërmirësueshëm, me ç'rast kemi fillua edhe me konfiskime. Me këto veprime kemi arrit të zvogëlojmë prerjet ilegale deri në 90 %, dhe nëse jemi të vendosur, me siguri do të stabilizohet plotësisht situata. Më 2009 kemi pas 1560 fletparaqitje, ndërsa me 2010 kemi pas 680 FP (për gjysmë më pak), shënime këto që tregojnë edhe ritjen e prerjeve legale. Nga rojet ne kërkojmë ndërprerjen e jo fletparaqitje, ngase ata kur dojnë, dinë si me ndalë dukurinë negative. Në fillim kemi pasur kërcënime ngase ishte bërë zakon një lloj biznesi me dru sesa që janë përmbush kërkesat e qytetarëve, dmth tash kemi arrit tek prerjet legale. Në këtë drejtim na ka ndihmua shumë policia dhe dënimet e larta, kështu që njerëzit kanë fillua të

shesin mjetet me të cilat kanë punuar ilegalisht (transporti ilegal). Suksesi i komunave është në sensibilizimin e faktorëve relevant.

Në disa pyetje të parashtruara nga anëtarët e komisionit, përgjigjet ishin se lejet duhet të parashtrihen vetëm në komunë e jo edhe aty edhe në qendër (pyjet private). Për mungesë të stafit duhet me ndërhy në Qeveri ngase një roje nuk mundet të mbrojë 3000 ha, ndërsa paga 180 euro, tani e ritur, nuk mund të shpëtoi nga keqpërdorimet.

Përfaqësuesi serb nga **Shtërpca** diskutoi ngjashëm në frymën e diskutuesve të gjertanishëm, ngase moskënaqësia me qeverisjen lokale ka lindur për shkak se premtimet për staf nuk i ka mbajtur APK, gjithashtu kjo komunë vepron me pjesën shqiptare të komunës, ngase pjesa tjetër është në duartë e “Sërbija Shume” dhe deri tani nuk ka pas kalim të kompetencave të tyre në APK. Ai kërkoj ndihmë nga komisioni sa i përket kompetencave dhe mjeteve financiare ngase bashkëpunimi i deritashëm nuk solli fryte. Tri subjekte për menaxhim të pyjeve solli vetëm shkatërrim të pyjeve. Banori i maleve nuk mundet të furnizohet me dru në mal, derisa çmimi i drunjve është tepër i lartë (35 euro). Kërkesat sillen vërdallë, procedurat janë të zgjatura me shpenzime të panevojshme. Kërkesa dorëzohet, pastaj kalon 45 ditë derisa mer ndonjë informatë. Ai në fund kërkoi dhe përsëriti kërkesën për siguri logjistike, staf, tendere etj.

Përfaqësuesi i **Deçanit** ishte mjaft kategorik dhe i zëshëm në parashtrimin e problemeve aktuale në pyje ngase mbas luftës pyjet janë ardhë në një gjendje katastrofike sikur me dasht me qëllim të dëmtoi njeriu vehten, si tha ai. Komunat kanë pranuar kompetencat e ofruara nga ligji pa ditur mirë problemet si janë dhe me një inventarizim formal, pa ditë mirë gjendjen reale. Nuk ka nevojë të marim shembull ligjet e shteteve tjera p.sh. Austrisë, Suedisë etj ngase Suedezi p.sh. del e blen për kërshtëndella një bredh dhe nuk e prenë atë të njomën që e ka në oborr, pra ku jemi ne këtu. Komunat tona përfitojnë vetëm kërbacin, ngase kanë trashëguar staf të korruptuar 13 vite. Ne në Deçan, vazhdoi, kemi ndërpre tenderimet dhe kemi lejua vetëm dy të vazhdojnë. Ne po mundohemi me ba atë çka vepron Gjilani, por nuk po mundemi, hallall ju qoftë atyre. Ne kemi plot recidivistë dhe assesi të shpëtojmë nga ata të cilët sillen sikurse në “bahqe t’babës”. Edhe pse i kemi ndalë tenderat, popullata duhet të shërbehet, drunjt po shiten 45 euro. Për ligjin që po mundohemi këtu, ne duhet vet të zbatojmë. Ai pohoi se kanë bashkëpunim me SNV Holandeze, por duhet më tepër të përafrohen qëndrimet sa i përket materialit që konfiskohet, ngase buxheti duhet me mbështet ligjin. Një roje duhet të caktohet sipas vendit si është (rajoni-guror) sipas terrenit, përveç kësaj Qeveria asnjëherë nuk ka menduar për rrugë, ndodhë p.sh. zjarri por zjarrëfiksat nuk kanë si të shkojnë me fikë zjarrin, pra nuk kemi investime në infrastrukturë. Rojet nuk kanë uniformë dhe radiolidhje, derisa hajnat kanë radiolidhje, në majet e malit edhe me desht nuk mundemi të shkojmë. Me ligj duhet të përcaktojmë çka dëshirojmë, rolin mbikëqyrës, mungojnë inspektimet-qasjet në terren, sharrat duhet të licencohen.

Përfaqësuesi i **Pejës** tha se duhet të them pak, sepse u thanë shumica e gjërave, por Rugova kërkon një qasje të veçantë. Rreth demarkacionit me Malin e Zi ai tha se mjaft është analizuar por duhet me thënë atë që është se aty veprohet ligjërisht, shfrytëzojnë zonën ligjërisht. Sa i përket menaxhimit komunal, ai tha se prona private duhet të kalojë në komuna, ngase që nga viti 1982 komuna ka heshtur problemet e administrimit me tokë private. Prej atëherë janë shumë lëndë në Gjykata, ndaj kjo çështje duhet të rregullohet duke ndarë çështjet publike nga ato private. Lëndët e tenderëve të vitit 2010 kalojnë në vitin 2011.

Përfaqësuesi i **Podujevës** potencoi problemet e ngjashme ku është kërkuar rexhistrimi real i pyjeve për shkak të degradimit të tyre afro 80%, prandaj duhet bërë ripyllëzimet, rojet të armatosen sepse më 6 janar 2011 është vrarë një roje e pyllit krejt për fajin e policisë dhe gjykatës. Te ne p.sh roja e kryen mirë punën, por druri i transportuar është mall, me çka nuk mirët policia. Prej 900 FP asnjë nuk është shqyrtuar deri tani. Në këtë komunë problem është edhe futja lirshëm nga Serbia. Kryeshefi i APK reagoi dhe tha se në pyetje janë vulosja me çekanët.

Përfaqësuesi i **Prizrenit** tha se ky qytet mund të përdoret si model i mbrojtjes së pyjeve. Problemet në këtë komunë janë dëmkosja pa kritere nga parku nacional, masa drusore me dokumente të “Sërbija Shumës”, ekzistojnë 11 roje që dmth një roje mbronë 2300 ha, dy boca për zjarre eventuale, shfrytëzimi i guroreve pa kritere dhe pa kontratë. Njerëzit që jetojnë afër pyjeve duhet të paguajnë 35 euro drunjt.

Përfaqësuesi i **Istogut** tha se 60% e pyjeve këtu janë shtetore (20.000 ha) dhe ende vazhdon konsolidimi në këtë fushë, nuk është zbatua asnjë tender, pyjet janë në një situatë të degraduar, për 10 vite pyjet janë shkatërruar sikurse me qenë në pyetje 100 vjet, kalimi i kompetencave në komuna nuk është sqaruar sa duhet, kemi burokraci të panevojshëm, drunjt e konfiskuar janë ndarë familjeve skamnore, kemi ndërtuar dy lura (ndalesa) por nuk janë paguar puntorët, përqindja e të hyrave duhet të ndryshoj-70% komunave të takojnë sepse ka investime të shumta, koeficienti i puntorëve duhet të ndryshoj nga 4.5 sa është tani, për të ndaluar prerjet ilegale duhet që Gjykatat të janë efikase 100% bashkë me policinë, gjatë vitit 2010 nga 495 FP vetëm një është miratuar, asnjë nuk është shqyrtue, dmth hallka kryesore është Gjykata sidomos sa i përket recidivistëve.

Nait Hasani falënderoj për diskutimet dhe ftoi pjesmarrësit të përafrojnë qëndrimet pasi po afrohet fundi i takimit, ai tha se të gjitha këto diskutime janë evidentua dhe do të janë pjesë e punës së komisionit në punën e mëtejme, njëherit shprehu optimizmin pasi që nga disa diskutues u dëgjuan tone pozitive sa i përket zvogëlimit të problemeve me anë të kompetencave të kaluara në komuna, por me siguri ka ende mjaft për të bërë.

Daut Haradinaj tha se i takon regjionit të Dugagjinit dhe personalisht posedon tokë afër kufirit të Malit të Zi dhe premtoi se do të filloj iniciimin e këtij demarkacioni, në këtë drejtim do të mundohet për eliminimin e masakrimit dhe shkatërrimit total të pyjeve në këtë anë duke inicuar zgjidhjen e problemeve përmes këtij komisioni duke filluar me ritjen e koeficientit për rojet e pyjeve dhe ashtu me radhë, ai i luti pjesmarrësit të janë aktiv dhe bashkëpunues edhe përmes kërkesave me shkrim në këtë komision, të cilat do të bashkëngjiten ligjit që do të vjen në shqyrtim, ngase qëllimi i përbashkët i të gjithëve është ruajtja e pyjeve.

Liburn Aliu pyeti pse ligji i premtuar për pyje nuk vjen si ligji i ri por si ndryshim, pasoi sqarimi nga Hysen Abazi që fjala është për ligj të ri që hartohet. Për kryeshefin kishte pyetje nga kush më tepër prehen pyjet.

Salih Morina pyeti sa është aktiv APK me Gjykatë.

Nijazi Idrizi konstatoi polarizimet nga ky takim sa i përket ndalimit të prerjeve ilegale, dikush konstaton se janë ndaluar e dikush jo, por qensore është se ligji i vitit 2003 për 10 vite gabimisht i është qasur çështjes së pyjeve, dmth duhet të zbatohet prerjet legale me ç’rast vetvetiu pastaj eliminohen prerjet ilegale. Momentalisht duhet të shikohet çështja e sasisë që konsumon çdo familje për ngrohje në mënyrë që mos ti kushtoj shtrenjtë ngrohja për një familje, ngase mirëqenja e familjeve tona nuk përballon çmimet e larta. E dyta, derisa në njerën anë po konfiskohen drunjtë, në anën tjetër nuk po arrijmë të plotësojmë drejtën elementare të njeriut për ngrohje në mënyrë legale. Qasja jonë në problemet e mëdhaja me pyje duhet të jetë më e mirë, ngase deri tani ka qenë e gabuar, duhet të kemi një ligj që do të zbatohet.

Afërdita Berisha pyeti cilat janë kriteret për të fituar tenderin një kompani për prerje të pyllit. **Përfaqësuesi i Gjilanit** tha : të jetë i licencuar, si ka punuar kompania më parë dhe cili është çmimi më i volitshëm. Reagoi përfaqësuesi i Deçanit dhe tha se kushtet formale-kriteret duhet ti caktoi komuna. Gjithashtu reagoi përfaqësuesi i Podujevës i cili tha se UA nr.06/2010 i cakton këto kritere.

Sevdije Lama pyeti deri kur kështu do të zgjatë mosdefinimi i kompetencave dhe çka është më efikase.

Kryeshefi i APK u përgjigj në disa pyetje dhe tha se më vjen mirë që disa komuna po konstatojnë gjendjen e mirë por situata reale është jo e kënaqshme, ngase pjesa më e madhe e drunjve është ilegale, ndaj konstatimi i tij ishte se duhet të zbatohen planet dhe të kërkohej jo kompetenca por analiza të kompetencave komunale. Me ligjin e ri duhet të zbatohen planet,

të shiten drunjt sipas prokurimit publik, ngase nëse nuk shiten drunjt e konfiskuar, atëherë si do të krijohen të ardhurat. Ai përfundoi me konstatimin se duhet fillimisht të shihet gjendja reale.

Hysen Abazi konstatoi se pyjet janë duke u ritur por nuk ka vend për kënaqësi ngase planifikimi tani është gjëja e parë që duhet të bëhet ngase pikërisht kjo shkakton mosrealizimin e planit që shkon në favor të prerësve ilegal p.sh. fituesi i tenderit shkon dhe i prenë drunjt më të mirë sepse thotë se nuk i shiten dmth duhet planifikim të mirëfillt. Në anën tjetër hajnat e bllokojnë tregun. Ndoshta disa komuna kanë drejt që kërkojnë 70%, duhet analizuar vetfinancimin, pse buxheti me financua.

Liburn Aliu njoftoi se NFG Norvegjez ka konstatuar prerje ilegale për shkak të vonesës së lejeve komunale, ndaj për shkak të këtyre shifrave të mëdhaja të prerjeve dhe për shkak të FP nga APK, pyeti pse këto vonesa dhe a janë marr parasysh në ligj këto çështje.

Në anën tjetër mosqartësimi i kompetencave në mes dy niveleve (komunale dhe qendrore) a pamundëson efikasitetin në rafshin e pastrimit të pyjeve dhe si mundet të involvohet këtu qytetari p.sh. në Deçan ka mjaft pyje (drunjt) të kalbur dhe të thatë, konkretisht a mundet të organizohet komuniteti në këtë drejtim (për pastrim). Kryeshefi i APK tha se komunat janë ato që mundet me planifikue sipërfaqet pyjore që duhet të trajtohen dhe të radhohen me qytetarët bashkë, derisa APK për këto çështje gjithmonë ka qenë e gatshme, kërkesat parashtrihen deri më 31 mars të vitit vijues të cilat shqyrtohen deri para vitit të ri.

Nait Hasani kërkoi sqarim për mbrojtjen e pyjeve sipas nenit të cituar sipas ndryshimeve të ligjit të vitit të kaluar, dhe kërkoi raportet nga komunat për ato që u folën sot në takim ngase kur vjen projektligji do të kemi edhe një dëgjim publik më të përgatitur, ndërsa Hysen Abazi u përgjigj se pikërisht në ligjin që është duke u hartuar jemi ndalë në qartësimin e pyetjes kush administron, kush qeverisë, kush menaxhon, çka do të thotë se nëse përzihen prapë këto terme, prapë do të kemi probleme (kjo ishte edhe përgjegjja në pyetjen e Sevdije Lamës). Sa i përket konstatimit nga NFG Norvegjez mund të them se ku ka prerje ilegale aty nuk ka certifikim. Për lejet për pyje private në ligj hyjnë vijat e trasha të cilat i qartëson UA (udhëzimi administrativ), me këtë rast maltretohet popullata, në emër të pastrimeve pësojnë pyjet. Reagoi përfaqësuesi i Deçanit dhe tha se kjo ka ndodhë që 10 vite, prej Prishtinës është vjedhë në Deçan.

Lidhur me Shtetçi **kryeshefi i APK** tha se kanë bërë kërkesë me mbulua këtë komunë dhe sigurimin e mjeteve shtesë për komuna të reja, për një shumë simbolike, për roje etj.

Nait Hasani falënderoi pjesëmarrësit dhe premtoi se do të shihen nëpër komuna (të hënën në Deçan), kur del komisioni të mbikëqyrë sipas detyrës zyrtare, ndërsa mysafirët poashtu falënderuan.

Lidhur me këtë mbledhje është proceduar edhe kërkesa për transkript.

Në fund **Nait Hasani** konfirmoi për komisionin se nënkryetari **Liburn Aliu** është anëtarë i GP për monitorimin e ligjit për tokën Bujqësore, i cili grup nesër vazhdon punën.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,00.

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani